



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2731 / Prot.

Tiranë, më 22/12 /2022

VENDIM

Nr. 25, datë 22.12.2022

PËR

**MIRATIMIN E PROPOZIMIT PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT
TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË INXHINIERI MATEMATIKE NË
FAKULTETIN E INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKE, NË UPT**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" i ndryshuar, Udhëzimit të MAS Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, kërkesën e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike dhe Rregulloren e Studimeve të Doktoratës të UPT-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 22.12.2022,

VENDOSI:

Miratimin e propozimit për riorganizimin e programit të studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në Inxhinieri Matematike dhe miratimin e katër projekteve kërkimore-shkencore në "Ndërtimi i modelit matematik për vlerësimin e përputhshmërisë në tekstet shqip", "Ndërtimi i modeleve matematike diferenciale për përhapjen e sëmundjeve epidemike-fokus pandemia Covid-19. Projektimi dhe vlerësimi në kohë reale i efektivitetit të masave të kontrollit", "Studim krahasimor i metodave të ndryshme të analizës hapësinore të të dhënave të rreshjeve për modelimin hidrologjik në shkallë pellgu ujëmbledhës. Rast studimor për rajone të caktuara të Shqipërisë (Pellgu ujëmbledhës i Prespës)" dhe "Metoda të avancuara numerike për simulimin e materialeve sintetike", në Fakultetin e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Andrea Maliqari

